



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Bali Muahrremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës Bexhet Kuçi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, U.D, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, U.D, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 06/10/2023
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit të Monitorimit Driton Xhafa, Zyrtar për Monitorimin e Komunave	Nr. 020-61/4
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë e aktit të komunës së Suharekës	
Lloji i aktit:	Vendimit	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 16/64031 për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-7541 të datës 29.01.2021
I miratuar më datë: 28.09.2023
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 29.09.2023

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.09.2023, ka miratuar Vendim Nr. 16/64031 për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-7541 të datës 29.01.2021.

MAPL, konstaton se vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Suharekës është i bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale neni 12, Ligjin Nr.06/L-92 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës nenin 22 dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës neni 27.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Suharekës me datë 28.09.2023, me 17 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim. Vendim Nr. 16/64031 për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-7541 të datës 29.01.2021 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në nëntëdhjetë nëntë (99) vite të pronës së paluajtshëm të Komunës bëhet për arsye se "Fituesi nuk ka pranuar ta nënshkruaj kontratën sipas obligimeve që kanë qenë të parapara në nenin 3".

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za :	Bali Muahrremaj, gradonačelnik opštine Suva Reka Bexhet Kuçi, predsedavajući Skupštine opštine Suva Reka	
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Jeton Qela, V.D, generalnog sekretara MALS-a,	
Od:	Besim Myrtezani, V.D, rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština / MALS	Dana, 06.10.2023
1.Službenik za potvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac odseka za monitorisanje opština	br. 020-61/4
2. Službenik za izradu pravne ocene	Driton Xhafa, službenik za monitorisanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Suva Reka	
Vrsta odluke:	Odluka	

Poštovani/a gradonačelnice,

Poštovani/a predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br: 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2021, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 16/64031 o stavljanju van snage Odluke 01-Nr-016-7541 od 29.01.2021.godine

Usvojena dana, 28.09.2023. godine,

Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 29.09.2023. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Skupština Opštine Suva Reka je na sednici održanoj 28.09.2023. godine, usvojila Odluku 16/64031 o stavljanju van snage Odluke 01-Nr-016-7541 od 29.01.2021.godine

MALS konstatuje da je usvojena odluka od strane Skupština opštine Suva Reka, zasnovana na Zakonu br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, član 12, Zakonu br. 06/L-92 o davanju na korišćenje i razmenu imovine, član 22 i Uredba (VRK) br. 09/2020 o utvrđivanju postupka davanja na korišćenje i razmenu opštinske nepokretne imovine, član 27.

Odluka je usvojena na sednici Skupštine opštine Suva Reka dana, 28.09.2023.godine, sa 17 glasova za, 0 protiv i 0 uzdržanih. Odluka br. 16/64031 o stavljanju van snage Odluke 01-Nr-016-7541 od 29.01.2021.godine, o davanju na dugoročno korišćenje do devedeest i devet (99) opštinske nepokretne imovine vrši zbog razloga „Korisnik nije pristao da potpiše ugovor u skladu sa obavezama koje su predviđene članom 3”.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.